



Datë: 05.11.2025
Numër Protokolli: 7394/2025

A.nr.1465/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1465/2025 të datës 25.07.2025, të parashtruar nga ankuesi F.L, kundër organit të punësimit: Agjencia Kosovare e Privatizimit, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, më datë 05.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1465/2025 e datës 25.07.2025, **ashtu që detyrohet** U.D Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kosovare të Privatizimit që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi të shqyrtoj Rekomandimin e datës 30.04.2025, të Komisionit për Kërkesat e Zyrtarëve Kadastral për rishikim të pagës, dhe të nxjerr akt administrativ në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil F.L (*tutje referuar vetëm* ankuesi), më datë 25.07.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të organit të punësimit ndaj kërkesës së datës 11.04.2025, lidhur me kategorizimit të pozitës së tij Zyrtar Kadastral në kuadër të kategorisë së Specialistëve sipas Gradës dhe Hapit 4-4.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 12.08.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Agjencia Kosovare e Privatizimit, ndërsa kjo e fundit më datë 20.08.2025 ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit), pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se meqenëse nuk është nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e ankuesit, atëherë ekziston baza ligjore që të detyrohet U.D Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kosovare të Privatizimit që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të shqyrtoj Rekomandimin e datës 30.04.2025, të Komisionit për Kërkesat e Zyrtarëve Kadastral për rishikim të pagës, dhe të nxjerr akt administrativ në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi, **sepse:** Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ankuesi sipas Akt Emërimit me referencë 61/DKR 14 të datës 18.10.2023, është i punësuar në pozitën Zyrtar Kadastral si Specialist, klasa I11 dhe koeficienti 7, në Divizionin e Kadastrit në kuadër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Tutje sipas shkresave të lëndës, ankuesi me datë 11.04.2025, ka parashtruar kërkesë tek Komisioni për Rishikim të Pagës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes të cilës ka kërkuar që të bëhet korrigjimi i gradës dhe hapit nga ai aktual 5-8 në gradën dhe hapin 4-4, mirëpo ankuesi nuk ka marr përgjigje në raportin me kërkesën e tij.

Ndërsa, sipas shkresave të lëndës të bashkangjitura në përgjigjen në ankesë të datës 20.08.2025, të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, rezulton se Komisioni për rishikim të pagës me datë 30.04.2025, ka nxjerrë Rekomandimin për Kërkesat e Zyrtarëve Kadastral për rishikim të pagës, duke theksuar se, citoj: “ *DBNJ, e vlerëson kërkesën e zyrtarëve kadastral të datës 7 prill 2025, si kërkesë të arsyeshme e cila ka mbështetje ligjore, andaj jep këtë: 3. Rekomandim: Kërkesa e Zyrtarëve Kadastral, e datës 07.04.2025, të trajtohet nga Grupi Punues për Ndryshimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, i themeluar me vendimin DE 658/2025 të datës 18.04.2025, i cila ka kompetenca për ta trajtuar dhe propozuar ndryshime në Rregullore për miratim nga Bordi i Drejtorëve.*” Mirëpo, që ky rekomandim rezulton si i pa nënshkruar nga U.D Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, rrjedhimisht rekomandimi si i tillë rezulton se as nuk është aprovuar por as refuzuar.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të organit të punësimit ndaj kërkesës së datës 11.04.2025, pretendon se edhe përkundër faktit që pozita e tij sipas akt emërimit është kategorizuar si Specialist dhe është e paraparë sipas Rregullores Nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës por kjo nuk është reflektuar në Rregulloren Nr. 13/2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores së Pagave të Agjencisë, sepse aktualisht kjo pozitë është paraparë në gradën dhe hapin 5-8 e që duhet të parashihej në gradën dhe hapin 4-4.

Rrjedhimisht, ankuesi kërkon nga Këshilli aprovimin e ankesës, me obligimin që Agjencia Kosovare e Privatizimit të korrigjoj klasifikimin dhe koeficientin e pagës së tij, nga grada-hapi 5-8 në gradën-hapin 4-4, të kompensohet në mënyrë retroaktive nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe të obligohet AKP të përditësoj Rregulloren Nr. 13/2023, duke e përfshirë këtë pozitë në kuadër të pozitave specifike deficitare në kategorisë e Specialistëve.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me rregullat e veprimeve procedurale të një organi publik, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (*tutje referuar: LPPA*), përkatësisht nenit 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *2. Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative*, nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj*, si dhe nenit 97 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: *1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative*, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes, Kolegji i Këshillit konstatoi se organi përkatës i punësimit, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat përkatëse ligjore, në raport me Kërkesën e datës 07.04.2025, të parashtruar nga ankuesi, gjegjësisht Rekomandimi i datës 30.04.2025, i Komisionit për Kërkesat e Zyrtarëve Kadastral për rishikim të pagës, nuk është se është aprovuar por as refuzuar nga U.D Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ngase sipas bazës ligjore si me sipër, vullneti i organit publik në realizimin e autoritetit publik formësohet në procedurë administrative dhe manifestohet në formën e njërit prej veprimeve administrative, siç janë: akti administrativ; kontrata administrative apo akti real, dhe se në vlerësimin e Kolegjit, organi përkatës i punësimit, në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, është dashur që të nxjerr akt administrativ në kuptim të vendosjes dhe të njoftoj palën për aktin e tillë, brenda një afati prej 45 ditësh sikurse përcaktohet me nenin 98 paragrafi 2 apo afatit të vazhduar sipas nenit 99 paragrafi 1 të LPPA-së.

Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, heshtja e organit të administratës, në këtë rast, U.D Drejtorit Ekzekutiv, në raport me Kërkesën e ankuesit, rrjedhimisht Rekomandimin përkatës të datës 30.04.2025, cenon të drejtat e ankuesit në kuptimin e të drejtave procedurale dhe për rrjedhojë edhe vendosjes në mënyrë meritore, ngase ashtu sikurse është thënë në arsyetim të këtij vendimi, në kërkesën e parashtruar tek organi i punësimit, ankuesi pretendon që të bëhet korrigjimi i gradës dhe hapit nga ai aktual 5-8 në gradën dhe hapin 4-4, dhe se organi përkatës i punësimit duhet të shqyrtoj kërkesën e tyre dhe të vendos lidhur me pretendimet e ngritura.

Kështu që thënë si me sipër e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të aprovoj si të bazuar ankesën e datës 25.07.2025, në kuptim të shkeljeve procedurale, dhe si rrjedhojë të detyroj U.D Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, që në respektim të dispozitave procedurale, të shqyrtoj Rekomandimin e datës 30.04.2025, të Komisionit për Kërkesat e Zyrtarëve Kadastral për rishikim të pagës, dhe të nxjerr akt administrativ në përputhshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1465/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, F.L;
- U.D Drejtorit Ekzekutiv dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.